



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-112
Prishtinë, më 13 korrik 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 13 KORRIK 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini, Xhezair Murati dhe Branislav Gërbiq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e Presidentit: Lumnije Murati,
Nga ZCN: Blerta Bejtullahu dhe
Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe pesë pika shtesë.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, njoftoi Kryesinë lidhur me ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare, nga radha e këtij grupi.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 6 dhe 8 korrik 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 6 dhe 8 korrik 2010

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 6 dhe 8 korrik 2010, u miratuan pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë, veç e veç, dhe me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që gjatë muajit korrik të mbahen dy mbledhje plenare:

Më 15 korrik 2010, me këtë

R e n d d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prishtinën,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ujërat e Kosovës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,

11. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

Më 22 korrik 2010, me këtë

R e n d d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i Raportit të punës të Avokatit të Popullit, për vitin 2009,
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2009,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2009,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Programin Kombëtar të Shkencës,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale, për vitin 2009.

Kryesia, pasi shqyrtoi Raportin e punës së Avokatit të Popullit, për vitin 2009, vendosi që ta ftojë Avokatin e Popullit, z. Sami Kurteshi, për ta arsyetuar para Kuvendit Raportin e punës të Avokatit të Popullit, për vitin 2009.

Ndërsa, sa i përket kërkesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ratifikimin e Marrëveshjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës me Bankën Botërore, Kryesia konstatoi se kjo çështje paraprakisht duhet të diskutohet brenda grupeve parlamentare, pastaj të radhitet për mbledhje plenare.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me propozimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave

Kryesia shqyrtoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me propozimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Propozim – vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave dhe Kuvendit t'i paraqesë Raportin me rekomandime, për procedim të mëtejshëm.

3.2 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me propozimin e anëtarit në Organin Shqyrtues të Prokurimit

Kryesia shqyrtoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me propozimin e anëtarit në Organin Shqyrtues të Prokurimit, dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Propozim – vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime, për procedim të mëtejshëm.

3.3 Kërkesa e Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë për t’u ngarkuar për Komision bashkëpërgjegjës për shqyrtimin e Propozim - Strategjisë së Sigurisë

Kryesia shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë për t’u ngarkuar për Komision bashkëpërgjegjës për shqyrtimin e Propozim - Strategjisë së Sigurisë, dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë dhe e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Inteligjencës që, si komisione të interesuara, ta shqyrtojnë Propozim-Strategjinë e Sigurisë së Republikës së Kosovës, bashkë me Komisionin përgjegjës-raportues - Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri.

2. Gjatë shqyrtimit të Propozim-Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Kosovës nga këto komisione, të mos organizohen dëgjime publike.

3.4 Njoftimi lidhur me skadimin e mandatit të anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Kryesia shqyrtoi njoftimin lidhur me skadimin e mandatit të anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, dhe nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta iniciojë procedurën dhe t’ia propozojë Kuvendit kandidatët për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

3.5 Njoftimi nga Komisioni parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për vizitën e realizuar në Bruksel

Kjo pikë ishte vetëm njoftim për Kryesinë e Kuvendit.

3.6 Shqyrtimi i kërkesës të Komisionit për Punë të Jashtme për lejimin e organizimit të Konferencës Rajonale në Prishtinë

Kryesia shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Punë të Jashtme për lejimin e organizimit të Konferencës Rajonale në Prishtinë dhe mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet organizimi i Konferencës Rajonale të komisioneve për punë të jashtme të parlamenteve të rajonit, me temën: “Bashkëpunimi rajonal dhe integrimet evropiane”, që do të mbahet në javën e tretë të shtatorit 2010, në Prishtinë, nën organizimin e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës do t’i mbulojë të gjitha shpenzimet e pjesëmarrësve në Konferencën rajonale të komisioneve për punë të jashtme të parlamenteve të rajonit.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte për lejimin e mjeteve për mbajtjen e Konferencës Ndërkombëtare të Arsimit

Kryesia shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte për lejimin e mjeteve për mbajtjen e Konferencës Ndërkombëtare të Arsimit, dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia nuk mbështet kërkesën e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte për lejimin e mjeteve për mbajtjen e Konferencës Ndërkombëtare të Arsimit.
2. Për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare të Arsimit lidhur me temën - Sfidat e sistemit arsimor në Kosovë në raport me sistemin e Bolonjës, është e domosdoshme të sigurohen bashkorganizatorë dhe bashkdonatorë (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë).

3.8 Shqyrtimi i kërkesës të Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e organizimit të Konferencës Rajonale në Prishtinë

Kryesia shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur për lejimin e organizimit të Konferencës Rajonale në Prishtinë, dhe nxori këtë:

VENDIM

1. Lejohet organizimi i Konferencës Rajonale të komisioneve parlamenteve për buxhet dhe financa të vendeve të rajonit, me temën: “Këmbimi i përvojave dhe diskutimi i

strategjive ndërmjet komisioneve parlamentare për buxhet të vendeve të rajonit”, që do të mbahet në javën e dytë të tetorit 2010, në Prishtinë, nën organizimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikë së Kosovës.

2. Projekti i GTZ-së për mbështetjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa do t’i mbulojë të gjitha shpenzimet, si dhe do të ofrojë mbështetje organizative në të gjitha aspektet e organizimit të konferencës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:00.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale